



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO**  
**KOMUNA E GJAKOVËS**  
**OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA**

---



## **Leje Ndërtimore**



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit  
Nr.07/351/02-24361  
Dt. 08.02.2024

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21 dhe Ligjit për procedurën administrative, Nr. 05/L-031, si dhe aplikacionit dhe dokumenteve të paraqitura, lëshon këtë:

**VENDIM**  
**(për Leje Ndërtimore)**

<b>Kjo Leje Ndërtimore i lëshohet:</b>			
Emri:	Vezir (Sadik) Agushi nga Gjakova.		
Adresa:	Rruga "Mazllom Shasivari" pn.		
Telefoni:	049 428 910	Emaili:	

Emri i Projektit:	Ndërtimi – ngritja e katit të parë të lokalit, në objektin ekzistues me etazhitet E(B+P)+1.		
Emri i Projektuesit:	N.P. "Alba-Conark" AZH – Gjakovë.		
Adresa:	Rruga "Isa Boletini", nr. 2.		
Telefoni:	044 122 818	Emaili:	



<b>Për punët ndërtimore në vijim:</b>			
Adresa: Brekoc			
Zona(t) Kadastrale: Brekoc	Nr. i parcelave kadastrale: 313-63	GPS Koordinatat:	

<b>Lloji i ndërtimit të propozuar:</b>			
Ndërtim i ri	<input checked="" type="checkbox"/>	Rindërtim	<input type="checkbox"/>
Riparim	<input type="checkbox"/>		
<b>Kategoria e ndërtimeve të propozuara:</b>			
Kategoria I	<input checked="" type="checkbox"/>	Kategoria II	<input type="checkbox"/>
Përdorimi i propozuar:	A përfshin kërkesa ndryshim të destinimit? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/>		
Përshkrimi: Lejohet ndërtimi ngritja e katit të parë të lokalit, në objektin ekzistues me etazhitet E(B+P)+1.			

Me këtë vendim, poseduesit të lejes ndërtimore **Vezir (Sadik) Agushi nga Gjakova** i lejohet ndërtimi - ngritja e katit të parë të lokalit, në objektin ekzistues me etazhitet E(B+P)+1, me sipërfaqe të përgjithshme (bruto) për ndërtim  $S= 119.33 \text{ m}^2$ .

**Kati i parë:** (Sip.Bruto):  $S=119.33 \text{ m}^2$

**Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:**

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin;
- Te vendose tabelën informuese në vend ndërtim me informatat e mëposhtme:
  - informata mbi Lejen Ndërtimore
  - informatat mbi projektuesin
  - informata mbi kontraktuesin
  - prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit
- Të sigurojë që kontraktuesi në vend ndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
  - një kopje të kësaj leje ndërtimore;
  - një kopje të kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë;
  - një kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të “APROVUAR” nga organi kompetent;
  - projektin kryesor me të gjitha fazat për nevojat e realizimit të ndërtimit;
  - dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
  - librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;
  - protokollin e miratuar të nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;
  - Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
  - Të njoftoj organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuata dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;
  - Të njoftoj organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveç në rastet kur:
    - o ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
    - o ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero pjesje një (0,1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
    - o ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
    - o Të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.

REPI  
Gjal  
Drekt  
HY  
KESH  
KESH  
KESH



# A r s y e t i m

Aplikuesi: **Vezi (Sadik) Agushi nga Gjakova** me banim në rrugën “Musa Zajmi” përmes kërkesës së evidentuar me nr. 07-351/02-24361 të datës 29.12.2023, të parashtruar DUMM-së, ka kërkuar nga organi kompetent lëshimin e Lejes Ndërtimore për ndërtimi - ngritja e katit të parë të lokalit, në objektin ekzistues me etazhitet E(B+P)+1, në ngastrën kadastrale me numër: 313-63, ZK: Brekoc, në pronësi të Vezi (Sadik) Agushi nga Gjakova.

DUMM – Gjakovë, përkatësisht zyrtari përgjegjës për lëndën, pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të ndërtimor të lëndës, si dhe bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, Ligjit për procedurën administrative, Nr. 05/L-031 dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Plani i Situacionit 1: 500 i vërtetuar nga DUMM, dt. 08.11.2023.
- Kopjen e planit së bashku me Certifikatën mbi të drejtën në pronësi e paluajtshme në pronësi të Vezi (Sadik) Agushi nga Gjakova lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
- Vendimin për Kushte ndërtimore me nr. 07-351/02-18985, dt.08.11.2023, lëshuar nga DUMM.
- Aktvendimin me nr 05-351-883, dt. 18.10.1986, lëshuar nga Sekretariati për Urbanizëm, punë komunale e strehimore i komunës së Gjakovës së bashku me planin e situacionit.
- Vërtetimet mbi kryerjen e obligimeve.
- Pëlqimi – Certifikata e inspektoratit sanitar me nr. 14-530/01-23658 të datës 13.12.2023.
- Raporti i arsyeshmërisë për lëndën nga Zyrtari Përgjegjës për Lëndën – Urbanisti.
- Vërtetimet mbi kryerjen e obligimeve nga tatimi në pronë.
- Pëlqimin nga KEDS-Gjakovë nr. 4/681 të datës 29.11.2023.
- Pëlqimin nga K.R.U. “Gjakova” Sh.A. Gjakovë, nr. 3224 të datës 14.11.2023.
- Pëlqimin nga PTK-Gjakovë, me nr. 408 të datës 15.11.2023
- Dëshminë mbi kryerjen e obligimeve nga taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në BKT, filiali në Gjakovë me datë 24.01.2024.
- Projektin kryesor, në 3 (tri) kopje të forta dhe 1(një) CD, i punuar nga N.P.“Alba-Conark” AZH – Gjakovë.

**Taksa administrative dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit është paguar në vlerën prej 193.31 Euro.**

- **Shtojcë:** Lejes së ndërtimit i bashkëngjitet: Plani i Situacionit së bashku me kushte lokacioni, me objektin sipas vijës së ndërtimit dhe rregullimit, në përpjesë 1:500 të datës 08.11.2023, të vërtetuar nga DUMM- Gjakovë.



**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke u llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj Drejtorie.

Nga një kopje të këtij vendimi t'i dërgohet:

- **Investitorit,**
- **Drejtorisë për Punë Inspektuese,**
- **Arkivit.**

**Hartoi aktin**

  
**Zenel Shabani Z.L. Ligjor**

**Zyrtari përgjegjës për lëndë**

**Mirlinda Mullahasani I.D.A.**

**Drejtori**

  
**Arben Bakalli**



OVA • R/